



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:157818
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05726347

Ac.nr.9145/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Lumni Salluka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E... S..... nga Lipjani, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor babai D..... S....., e të cilin me autorizim e përfaqëson B..... Z.... av. nga Fushë Kosova, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, Shehi “Nena Terez” nr. 33 për shpërblimin e dëmit, vlera e kontestit 24,000.00 euro, duke vendosur sipas ankesave të palëve ndërgjyqëse, të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, -Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.381/2018, të datës 11.08.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.381/2018, i datës 11.08.2021, në pikën I dhe III të dispozitivit, që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit jo material dhe shpenzimeve të procedurës, ndërsa tani çështja gjykohet si në vijim: **APROVOHET Pjesërisht** si e themeltë kërkesëpadia e paditësit E....S..... nga Lipjani dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit jo material si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 17.08.2018, paditësit t’ia paguaj shumat si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike-trupore shumë prej 5.000,00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 4.000,00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 2.000,00 euro dhe shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumë prej 1,132.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar ti llogaritet nga data 11.08.2021 e deri në pagesën definitive, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Eris Sinani nga Lipjani mbi shumat e gjykuara si më lartë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shpenzime të procedurës, refuzohet si e pathemeltë.

II. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar ankesa e paditësit E..... S.....nga Lipjani, **pjesërisht refuzohet** ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.381/2018, i datës 11.08.2021 në pikën e parë të dispozitivit që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e dëmit material në emër ushqimit të përforcuar, në emër të ndihmës së personit të tretë, në emër të shpenzimeve të shërimit dhe në emër të rehabilitimit me terapi fizikale, po ashtu pika e II-të e dispozitivit që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit, **VËRTETOHET.**

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar 381/2018 të datës 11.08.2021, në pikën e parë të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit E..... S..... nga Lipjani si të bazuar dhe e ka obliguar të paditurën, Kompania e Sigurimit “Illyria” me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të shpërblimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 17.08.2018, në rrugën afër shtëpisë së kulturës në Lipjan, t’ia paguaj shumat si vijon: për Dëmin jo material a) në emër të dhimbjeve fizike- trupore shumën prej 6.500,00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4.500,00 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 3.000,00 euro. Për Dëmin material a) në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 294,00 euro, b) në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë shumën prej 300,00 euro, c) në emër të shpenzimeve të shërimit shumën prej 7.13 euro d) për rehabilitim dhe terapi fizikale shumën prej 100,00 euro, të gjitha këto shuma, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 11.08.2021, e deri te pagesa definitive. Në pikën e dytë të dispozitivit, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit, më tepër se shumat e aprovuara, si pikën e parë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, REFUZOHEN si të pabazuara. Në pikën e tretë të dispozitivit e ka obliguar palën e paditur, t’ia paguaj palës paditëse shumat nga pika e parë e dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 1.440,00 euro të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmëris së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar në mënyrë që kontributi i paditësit në aksident të llogaritet 5% dhe të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensojë: në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 8.200.00 euro, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 6.700,00 euro, në emër të dhimbjeve fizike- trupore shumën prej 8.200.00 euro, me kamatë 8% si dhe të obligohet e paditura ti paguaj shpenzimet procedural për ankesë prje 208.00 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ka ushtruar ankesë edhe pala e paditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet në pikën e parë të dispozitivit lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë në të

gjitha format e dëmit jo metarial po ashtu të ndyshohet pika e tretë e aktgjykimit që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës, apo të refuzohet në tërësi si i e pa bazuar kërkesapdia e paditësit.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të neneve 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Ankesa e paditësit është në tërësi e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E..... S..... nga Lipjani, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor-babai D.... S....., e të cilët me autorizim i përfaqëson B..... Z....., avokat nga Fushë Kosova, me datë 09.10.2018, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli ne Prishtinë për kompensim dëmi material dhe jo material për shkak se me datë 17.08.2018, në afërsi të shtëpisë së kulturës në Lipjan, ka ndodh aksidenti i komunikacionit rrugor, në të cilin paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore. Aksidenti është shkaktuar si pasojë e lëshimeve të vozitësit të automjetit VW me targa 01-699-FC e cila ka pas sigurim nga auto përgjegjësia tek e paditura dhe mbi këtë bazë e paditura është përgjegjëse për kompensimin e dëmit. Me parashtresën e datës 26.05.2021, ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar që të obligohet e paditura, që paditësit t’ia paguaj ne emër te dhimbjeve fizike shumen prej 8.200,00 euro, për frikën e pësuar shumën prej 6.700,00 euro, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 8.200,00 euro, për ushqim të përforcuar shumën prej 350,00 euro për ndihmë dhe kujdes të personit të tretë shumën prej 300,00 euro dhe për shpenzime të shërimit shumën prej 100,00 euro dhe për rehabilitim shumën prej 150,00 euro, të gjitha këto me kamate prej 8% duke filluar nga data 29.09.2018 e deri te pagesa definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigje në padi dhe në seancat e mbajtura e ka kontestuar pjesërisht bazën e kërkesëpadiës, duke theksuar se edhe paditësi ka lëshime në këtë aksident të komunikacionit, ndërsa po ashtu e ka kontestuar kërkesëpadinë edhe për nga lartësia e saj, duke theksuar se shumata e kërkuara të dëmit jo material janë shumë të larta dhe nuk janë në proporcion me ekspertizat mjekësore te nxjerra nga gjykata, ka kërkuar që kamata të rrjedh nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit pasi qe paditësi nuk i është drejtuar me kërkesë për kompensimin e dëmit në procedurë administrative, përkatësisht kërkesa është dërguar gabimisht në adresë në Fushë Kosovë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.381/2018 të datës 11.08.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se nga ekspertiza e komunikacionit rrugor, të hartuar nga eksperti i komunikacionit rrugor dr. Sc. G.....H..... e muajit mars 202, rezulton se aksidenti është shkaktuar me lëshimet të ngasësit të

automjetit të tipit VW me targa 01-699-FC, i cili duke lëvizur me automjet në rrugën H.....K..... në afërsi të shtëpisë së kulturës në Lipjan, nga pakujdesia, me retrovizor të automjetit të tij e ka goditur paditësin në kokë (paditësi ishte në cilësi të këmbësorit) i cili pas kësaj goditje rrëzohet në tokë ku pastaj edhe me rrotën e pasme të anës së majtë e shkele dhe ja lëndon këmbën paditësit, e në të cilin aksident ka kontribuar edhe paditësi sepse ka ndërmarrë veprimin e kalimit të rrugës në pjesën e rrugës në të cilën nuk ka pas vendkalim të këmbësoreve dhe më parë nuk është siguruar se mund ta kalon rrugën sigurt. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertëve gjyqësor dr.A.....F..... ortoped tromatolog dhe dr.V..... S..... psikiatër, të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.04.2021, bazuar në raportin e QKUK-së të datës 17.08.2018 me nr. 31969, dhe raporteve tjera specialistike dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, rezulton se paditësi në këtë aksident të komunikacionit rrugor ka pësuar thyerje të pjesës distale të kërcyrit të majtë si dhe gërvishtje në dy bërrylat, lëndime këto të cilat konsiderohet si lëndime të natyrës së rëndë trupore. Mbi bazën e provave të administruara, si ekspertizës se komunikacionit rrugor, raportit policor nr. 2018-AR-1976 si dhe mendimit të eksperteve gjyqësor nga lëmi i ortopedis-tromatologjis dhe psikiatrisë, gjykata erdhi deri tek përfundimi se aksidenti i 17.08.2018 është shkaktuar me lëshimet primare te ngasësit të automjetit të siguar tek e paditura dhe me kontributin e paditësit, dhe atë me lëshimet prej 80% të ngasësit të automjetit të siguar tek e paditura dhe me lëshimet prej 20% të paditësit, në atë mënyrë, që përderisa ngasësi ishte duke drejtuar automjetin në rrugën afër shtëpisë së kulturës në Lipjan, duke mos pas kujdes të mjaftueshëm ndaj këmbësoreve, me retrovizor të automjetit të tij e godet paditësin, dhe pasi paditësi nga kjo goditje rrëzohet me për toke, me rrotën e pasme të anës së majtë ia shkel këmbën paditësit me crast i shkakton lëndime të rënda trupore, dhe me kontributin e paditësit në cilësi të këmbësorit i cili ndërmerr veprimin e kalimit të rrugës në pjesën e rrugës në të cilën nuk ka pas vendkalim të këmbësoreve dhe nuk është siguruar se janë plotësuar kushtet për kalim të sigurt të rrugës, kontribut ky të cilin gjykata e vlerëson prej 20%, duke u mbështetur në konstatimin dhe mendimin e ekspertëve gjyqësor, përkitazi me natyrën dhe shkallën e lëndimeve të pësuar, intensitetin dhe kohëzgjatjen e lëndimeve, mandej duke pasur parasysh moshën e paditësit i lindur me datë 24.01.2012, praktikën gjyqësore të gjykatave në Kosovë, si dhe duke i pasur parasysh lëshimet e pjesëmarrësve në aksidentin e komunikacionit rrugor dhe atë 80% të lëshimeve i siguruari i paditësit dhe me 20% të kontributit të paditësit në aksident, konform nenit 136, nenit 159 dhe nenit 169, nenit 176 paragrafi 1 dhe nenit 183 të LMD-së, nenit 323 të LPK-së, po ashtu në bazë të përgjegjësisë së paditësit dhe të paditurit e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendos si në dispozitiv të aktgjykimit. Lidhur me kamatën ligjore, gjykata vendosi sipas nenit 382 të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës vendimin e mbështeti në nenin 452 paragrafi 1 dhe 5 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë, në pjesët në të cilat i njëjti është vërtetuar nga kjo gjykatë e shkallës së dytë, si në dispozitivin e II-të të këtij aktgjykimi, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që në këto pjesë, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, as në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, e as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara me ankesë nga palët ndërgjyqëse, përveç pjesës së ndryshuar si në pikën I-rë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të cilën është ardhur në përfundim se gjykata e

shkallës së parë, gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe këto pjesë të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është dashur të ndryshohet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesërishme të kërkesëpadisë së paditësit, e në lidhshmëri me këtë e ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese, e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjykata i ka arsyetuar të gjitha rrethanat me peshë përcaktuese duke filluar nga përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit e deri te rrethanat që lidhen me kategorinë e dëmit. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë lidhur me bazën e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e dëmit, i pranon në tërësi Gjykata e Apelit duke i refuzuar pretendimet ankimore të palës së paditur në raport me përgjegjësinë, konkretisht në raport me kontributin e secilit pjesëmarrës në aksidentin e komunikacionit, respektivisht duke e ngakuar të paditurën me 80% të përgjegjësisë dhe paditësin me 20 % të përgjegjësisë në aksidentin e komunikacionit.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditëses në raport me përgjegjësinë e pjesëmarrëve në aksident janë të paqëndrueshme dhe si të tilla refuzohen si të pabazuara, ngase sipas nenit 159, paragrafi 2 të LMD-së parashihet se *“Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre”*. Në rastin konkret bazuar në ekspertizën e komunikacionit të hartuar nga eksperti, inxhinier i komunikacionit, Gëzim Hoxha me datë 05.03.2021, e cila ekspertizë është administruar si provë në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 11.08.2021, ku asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk ka pasur vërejtje, është konstatuar se pjesa e rrugës ku ka ndodhur aksidenti është rrugë e drejtë, e asfaltuar, dy kahore me nga një shirit qarkullues për secilën kahje. Nga lokacioni i aksidentit, vërehet se në afërsi të vendit të aksidentit ka qenë shkolla. Drejtuesi i automjetit, në çastin e paraqitjes së rrezikut, ka qenë duke lëvizur në shiritin e djathtë qarkullues të kahjes së tij, *por nuk ka pasur kujdesin e duhur gjatë lëvizjes në zonë urbane dhe ka reaguar me vonesë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për evitimin e aksidentit. Ngasësi i automjetit ka pasur mundësi teknike që me frenim ta evitoj aksidentin.*

Në rastin kur rruga kalohet nga persona me aftësi të kufizuara, nga persona të moshuar ose nga fëmijë, shoferi detyrohet ta ndalë automjetin, në mënyrë që t’ua mundësojë atyre personave që ta kalojnë rrugën. Në anën tjetër, këmbësori e ka filluar kalimin e rrugës në vendin jo adekuat (vendkalimi i këmbësorëve ka qenë në një distancë të afërt nga vendi i përplasjes së këmbësorëve) dhe pa u siguruar se mund ta kryej këtë veprim pa rrezikuar vehten dhe pjesëmarrësit tjerë në aksident. Mirëpo, në rastin konkret paditësi është fëmije i moshës gjashtë (6) vjeç. Marrë parasysh moshën e fëmiut, me të drejtë konstatohet se i njëjti nuk ka qenë i vetëdijshëm për shkaqet dhe pasojat e aksidentit dhe nuk ka pasur informacionin e duhur lidhur me rreziqet e mundshme të cilat mund ti paraqiten gjatë kalimit të rrugës si dhe masat të cilat duhet ndërmarrë paraprakisht me qëllimin e evitimit të rrezikut. Fëmijët, deri në moshën dhjetë (10) vjeçare kanë nevojë për ndihmë gjatë përdorimit të mjedisit të trafikut. Andaj, nisur nga kjo gjendje e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë me rastin e ndarjes së përgjegjësisë në aksident dhe atë 80 % të përgjegjësisë për vozitësin e automjetit të siguruar nga e paditura ngase është konstatuar se ka përgjegjësi primare në aksident, për faktin se i ka munguar

vigjilenca për ta evituar aksidentit i cili ka qenë e mundur që të evitohet, ndërsa edhe paditësi me veprimet e tij ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit por në rastin konkret duhet pas në konsideratë moshën e paditësit dhe aftësinë e tij për ti kuptuar veprimet e veta e si rrjedhojë edhe përgjegjësinë e tij për pasojat e dëmit, prandaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur me rastin e ndarjes së përgjegjësisë në anën e paditësit në lartësi prej 20 %, me të cilën ndarje pajtohet edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

Në anën tjetër, Gjykatës së Apelit i kanë rezultuar pjesërisht të bazuara pretendimet ankimore të të paditurës, sa i përket lartësisë së kompensimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbje fizike, për frikën e përjetuar dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor ashtu që, gjykata në vend të shumës së gjykuar prej 6.500,00 euro në emër të dhimbjeve fizike-trupore për paditësin, duke vlerësuar se këto shuma janë të larta dhe në disporporcion me pasojat e dëmit jo material dhe duke marrë për bazë standardin e praktikës gjyqësore të krijuar për këtë kategori të dëmit jo material, vlerësoi se kjo kategori duhet ndryshuar dhe për paditësin gjykoi shumën prej 5.000,00 euro, në emër të frikës së përjetuar në vend të shumës së gjykuar prej 4.500,00, duke vlerësuar se kjo shumë është e lartë dhe në disporporcion me pasojat e dëmit jo material dhe duke marrë për bazë standardin e praktikës gjyqësore të krijuar për këtë kategori të dëmit jo material, vlerësoi se kjo kategori duhet ndryshuar dhe për paditësin gjykoi shumën prej 4.000,00 euro, ndërsa për shumën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në vlerë prej 3.000,00 euro, duke marrë për bazë standardin e praktikës gjyqësore të krijuar për këtë kategori të dëmit jo material, vlerësoi se kjo kategori duhet ndryshuar dhe për paditësin gjykoi shumën prej 2.000,00 euro, duke i llogaritur këto shuma si proporcionale dhe ekuivalente në raport me konstatimet e ekspertëve mjekësor lidhur me këto kategori të dëmit jo material.

Gjykata e Apelit vlerëson se tani shumat e gjykuara për paditësit si në dispozitivin I-rë të këtij aktgjykimi janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 183 paragrafi 2 të LMD-së, të zbatuar për këtë rast dhe se kjo shumë përfaqëson një satisfaksion adekuat që të dëmtuarit (në këtë rast paditësit) ti përballojë më lehtë dëmet jo materiale dhe materiale të pësuar, edhe pse këto forma të dëmit nuk mund të vlerësohen e as të kompensohen me para. Me nenin 183 paragrafi 2 të LMD-së përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit (në rastin konkret paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore) ashtu që kompensimi për dhimbjet fizike të pësuar, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor i cili në rastin e paditësit nga eskeprtiza mjekësore u vlerësua të jetë në shkallë prej 5%, duhet të përfaqësoj një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit, e në të njëjtën kohë ato duhet të jenë reale dhe të paraqesin satisfaksion të vërtetë për aq sa është e mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Po ashtu shumat e gjykuara për paditësin janë në harmoni me udhëzuesin nr 41/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës për cakimin e kriterëve orientuese dhe lartësinë e shpërblimit të drejtë në të holla të dëmit jo material

të datës 27.02.2023 të cilat kritere mundësojnë zbatimin uniform të nenit 183, 184, dhe 185, të Ligjit 04/L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit e ka refuzuar ankesën e paditësit për sa i përket kërkesës për kompensimin e dëmit sikurse shumat e precizuara në kërkespadi si të pathemeltë, pasi që shumat e gjuhuara me këtë Aktgjykim për këto kategori të dëmit jo material janë në harmoni me lëndimet e paditësit dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadi së paditësit për kompensimin e dëmit material për ushqim të përforcuar, për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, për shpenzimet e shërimit dhe për rehabilitimin me terapi fizikale se paditësit me këtë rast kanë pasur nevojë për ushqim të përforcuar dhe ndihmën e personit të tretë. Forma të tilla të dëmit, është e vështirë, e pothuajse e pamundur, që të vërtetohen me prova konkrete, por praktika e gjykatave të Kosovës, i njuh forma të tilla të kompensimit, sa herë që konstatohet nevoja për to, përkatësisht për kategorin e dëmit material në emër të kujdesit të huaj dhe ushqimit të përforcuar. Kështu, meqë në këtë rast, në ekspertizë mjekësore është konstatuar se pala e dëmtuar ka pasur nevojë për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar, për periudhën e cekur në ekspertizë, atëherë shumat e gjuhuara në lartësinë e gjuhuar nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale me dëmin e shkaktuar për këto kategori, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmë dhe kujdes të huaj dhe ushqim të përforcuar. Po ashtu, edhe shpenzimet e mjekimit dhe rehabilitimit me terapi fizikale janë vërtetuar me këtë aktgjykim të gjykatës së shkallës së dytë, e cila konsideron se kompensimi i tyre, i caktuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm. Kjo për faktin se shpenzimet e mjekimit dhe rehabilitimit me terapi fizikale në shumën e aprovuar nga gjykata e shkallës janë vërtetuar nga provat të cilat i ka pasur në dispozicion e që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykatës së Apelit i rezulton si i drejtë vendimi i gjykatës së shkallës së parë edhe lidhur me vendosjen lidhur me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë bazuar në nenin 382 par.2 të LMD-së i cili shprehimisht përcakton “Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar pikën III të dispozitivit të Aktgjykimit të atakuar, duke refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim të shumës prej 208.00 Euro në emër të precizimit të kërkesëpadi si të pa bazuar, me arsyetim se paditësi kërkesëpadinë e tij duhet ta paraqet në gjykatën e shkallës së parë konform dispozitës së nenit 253 të LPK-ës, pra precizimi i kërkesë që nuk është bërë në fillim është shpenzim i krijuar me veprimet e paditësit dhe jo të paditurës dhe për këtë arsye bazuar në 449 dhe 452 të LPK-së, lidhur me TA-në, kjo gjykatë ka vendosur për refuzimin e kësaj kërkesë..

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë, në pjesët e vërtetuara të aktgjykimit të atakuar, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, përveç pjesës së ndryshuar. Andaj, në mbështetje të dispozitave të neneve 194 dhe 195, pikat d) dhe e), lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9145/2021 me datë 21.05.2024

**Kryetari i Kolegjit,
Ardian Ajvazi**